REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 36, datë 09.11.2026

PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE TË APLIKIMIT TË KOEFICIENTIT TË FASHAVE TË MBIKONSUMIT PËR SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË

Në mbështetje të neneve 13, 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar,

Komisioni Kombëtar Rregullator

në mbledhjen e datës 09.11.2026, pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin përkatës, të përgatitur nga Drejtoria Tekniko Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe Konsumatorit,

Konstatoi se:

1. Bazuar në pikën 1/a të nenit 13 të ligjit nr. 8102, i ndryshuar, ERRU në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve që parashikon ky ligj, do të veprojë në mënyrë të tillë që të nxisë eficencën dhe sigurinë nga ana e të licencuarit dhe përdorimin me efikasitet të ujit.

2. Bazuar në pikën 1/c të nenit 13 të ligjit nr. 8102, i ndryshuar, ERRU do të veprojë në mënyrë të tillë që të bëjë të mundur që të plotësohen të gjitha kërkesat e arsyeshme për furnizimin me ujë brenda kufijve të leverdisë ekonomike.

3. Faktorët mjedisorë, ndryshimet klimatike, periudhat e thatësirës dhe rritja sezonale e kërkesës për ujë, ushtrojnë presion të shtuar mbi burimet ujore dhe mbi kapacitetet e sistemeve të furnizimit me ujë.

4. Aplikimi i mekanizmit të fashave të mbikonsumit mbështetet në përdorimin racional të ujit, mbrojtjen e burimeve ujore, proporcionalitetin, transparencën, mosdiskriminimin brenda së njëjtës kategori klientësh, mbrojtjen e konsumit bazë dhe qëndrueshmërinë ekonomike të shërbimit.

5. Gjithashtu ai do të kontribuojë në përdorimin efikas të sistemeve publike të furnizimit me ujë dhe në ndërgjegjësimin e konsumatorëve për rëndësinë e kursimit të ujit.

6. Koeficienti i fashave të mbikonsumit zbatohet mbi tarifën volumetrike të miratuar për shërbimin e furnizimit me ujë.

7. Aplikimi i këtij mekanizmi duhet të mbështetet në të dhëna të verifikueshme mbi konsumin, kostot, kapacitetet e furnizimit, karakteristikat e shërbimit, ndikimin te konsumatorët dhe objektivat e mbrojtjes së burimeve ujore.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të pikës 1 (a) dhe (c) të nenit 13, pikës 1 (e) të nenit 14 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të miratojë mekanizmin e koeficientit të fashave të mbikonsumit për shërbimin e furnizimit me ujë, sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Koeficienti	Klientë familjarë (m^3/muaj)	Klientë publikë (m^3/muaj)	Klientë privatë (m^3/muaj)
1	1	Deri në 18	Mesatarja Historike (MH) e vitit të fundit	Mesatarja Historike (MH) e vitit të fundit
2	1 - 3	Mbi 18 deri në 30	Deri në 3-fishin e MH	Deri në 3-fishin e MH
3	1.5 - 4	Mbi 30	Mbi 3-fishin e MH	Mbi 3-fishin e MH

2. Konsumi bazë i ujit për secilën kategori klientësh tarifohet sipas tarifave të miratuara nga Komisioni Kombëtar Rregullator. Koeficientët për fashat pasuese aplikohen vetëm mbi sasinë e konsumit që i përket secilës fashë, pa ndikuar në tarifimin e konsumit bazë.

3. Shoqëritë ujësjellës kanalizime të licencuara mund të propozojnë pranë ERRU-së:

   a. aplikimin e koeficientëve të fashave të mbikonsumit në kuadër të aplikimit për nivel të ri tarifor, por jo më shumë se një herë në vit;
   b. aplikimin e koeficentëve të fashave të mbikonsumit në një aplikim të veçantë, por jo më shumë se një herë në vit.

4. Propozimi për zbatimin e koeficientëve të fashave të mbikonsumit shoqërohet me:
   a) Kërkesë për aplikimin e koeficientëve të fashave të mbikonsumit;
   b) Një relacion ku raportohen të dhëna mbi shpërndarjen e konsumit sipas kategorive të konsumatorëve, normat e konsumit bazë, kapacitetet e sistemit, disponueshmërinë e burimeve, efektet në të ardhurat e operatorit, planin për përdorimin e të ardhurave shtesë që pritet të krijohen nga zbatimi i koeficientëve të fashave të mbikonsumit.
   c) Vendimi i Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë ujësjellës kanalizime për miratimin e propozimit;
   d) Deklarata mbi vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të paraqitura e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.

5. Enti Rregullator i Ujit shqyrton aplikimin e paraqitur nga shoqëria për miratimin e koeficientëve të fashave të mbikonsumit, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e paraqitjes së tij. Komisioni Kombëtar Rregullator shprehet me vendim të arsyetuar për miratimin e koeficientëve të propozuar dhe periudhën e aplikimit të tyre.

6. Shoqëria duhet të aplikojë koeficientët e fashave të mbikonsumit vetëm për klientët e pajisur me matës.

7. Shoqëria ujësjellës kanalizime detyrohet të informojë konsumatorët 30 ditë përpara aplikimit të koeficientëve të miratuar.

8. Ngarkohen Drejtoria Tekniko Ekonomike për njoftimin e këtij vendimi shoqërive ujësjellës kanalizime.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gerta Lubonja